

KLSH-ZKA – zhvillohet takimi I i punës në kuadër të auditimit paralel me temë “Mbrojtja dhe Siguria e Digave”

1-2 prill 2025

Në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua takimi i parë i përbashkët ndërmjet grupeve të auditimit të KLSH-së dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, në kuadër të auditimit paralel të performancës me temë “*Mbrojtja dhe siguria e digave*”.

Qëllimi i këtij takimi dy ditor ishte diskutimi i dy grupeve të auditimit lidhur me situatën në Shqipëri dhe Kosovë sa i përket problematikave të evidentuara deri më tani lidhur me sigurinë e digave, qartësimin e kuadrit ligjor e rregullator, fokusimin në çështje me rëndësi, shkëmbimin e praktikave të mira kombëtare e ndërkombëtare, etj. Në përgjithësi, metodologjia dhe fushëveprimi i auditimeve të performancës në Shqipëri e Kosovë kanë shumë ngjashmëri sa i përket afateve, apo edhe komunikimit me subjektet nën auditim.



Diskutimet trajtuan gjithashtu çështje lidhur me adresimin e problematikave për sigurinë e digave duke shkëmbyer pikëpamje e konsiderata se çfarë mund/duhet të jetë pjesë e fokusit të auditimit dhe çfarë jo. U prezantua gjithashtu, vlerësimi dhe klasifikimi i digave sa i përket nivelit të riskut që ato paraqesin, praktikë kjo që nuk kryhet dhe nuk është e parashikuar në kuadrin ligjor/rregullator, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

Grupet e auditimit do të vijojnë komunikimin, me qëllim shqyrtimin e informacioneve dhe të dhënave shtesë më të detajuara, për të konkluduar në finalizimin e Programit të Auditimit.